

**KRIKË DHE BIBLIOGRAFI****KLAUS STEINKE**

***DIE VERBEN DES ALTALBANISCHEN: BELEGWÖRTERBUCH, VORGESCHICHTE UND ETYMOLOGIE (FOLJET E SHQIPES SË VJETËR: FJALORI I KONKORDANCE, PARAHISTORI DHE ETIMOLOGJI)/ STEFAN SCHUMACHER DHE JOACHIM MATZINGER. ME BASHKËPUNIM TË ANNA-MARIA ADAKTYLOS. - WIESBADEN: HARRASSOWITZ, 2013. - (ALBANISCHE FORSCHUNGEN; 33)***

Shqipja është një nga gjuhët më pak të njohura në Europë. Përkatësia e saj në familjen e gjuhëve indoeuropiane në fakt është e njohur prej kohësh, por për prejardhjen e saj, përkatësisht afërinë më të madhe brenda kësaj familjeje ka ende mendime shumë të ndryshme. Kjo lidhet para së gjithash me faktin se nga kjo gjuhë ka gjurmë shkrimore relativisht të vona. Dëshmitë më të hershme shumë të shkurtra janë të shekullit XV, ndërsa tekste më të gjata gjejmë vetëm në shekullin XVI. Prandaj në këto tekste mbështetet fjalori i vëllimshëm i dy gjuhëtarëve vjenezë Stefan Schumacher dhe Joachim Matzinger. Ai është rezultati i projektit të financuar nga Fondi Austriak për Zhvillimin e Shkencës *Foljet e shqipes së vjetër në kontekstin ballkanik*. Në qendër të vëmendjes është folja, pjesa e ligjëratës më e ndërlikuar dhe më e pasur me forma e gjuhës shqipe, për të cilën kohët e fundit Wilfried Fiedler ka hartuar një monografi të vëllimshme<sup>1</sup>.

Fjalorit të mirëfilltë të konkordancave foljore i praprin një hyrje e hollësishme dhe themelore<sup>2</sup> me këta krerë: A. Të përgjithshme, B. Ndërtimi i sistemit foljor të shqipes së vjetër, C. Mbi parahistorinë e kategorive të veçanta foljore, D. Sistemet fonematike të gegërishtes së vjetër dhe të toskërishtes së vjetër dhe transkriptimi i tyre, E. fonologji historike dhe F. udhëzime për përdorimin e fjalorit. Më tej vijon fjalori i konkordancave foljore (f. 287-961) me të gjitha format foljore nga veprat e Pjetër Budit, Frang Bardhit, Pjetër

---

<sup>1</sup> Das albanische Verbalsystem in der Sprache des Gjon Buzuku (1555)= Sistemi foljor i shqipes në veprën e Gjon Buzukut (1555) / Wilfried Fiedler. - Prishtinë : Akad. e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2004 - VI, 812 S. : Ill. - (Botime të veçanta / Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës; 55).

<sup>2</sup> Pasqyra e lëndës në: <http://d-nb.info/1041640021/04>

Bogdanit, Gjon N. Kazazit, Lekë Matrëngës dhe Jul Varibobës. Gjithashtu janë përfshirë edhe format e Buzukut të analizuara më parë nga Fiedleri. Në këtë mënyrë janë përfshirë autorët më të rëndësishëm, por aspak të gjithë autorët e shekujve XVII-XVIII. Janë marrë parasysh dëshmitë letrare nga periudha e hershme e gegërishtes dhe e toskërishtes, që këtu janë përmbledhur me emërtimin “shqipja e vjetër”. Nuk janë përfshirë në studim tekste të cilat dy studiuesit nuk kanë arritur t’i kenë në formë faksimile të origjinalit, në mënyrë që të siguronin standardin e njësuar për përfaqësimin e formave. Por meqenëse këto tekste nuk do të kishin sjellë ndonjë shtesë të ndjeshme në numrin e dëshmimeve foljore, kjo mangësi mund të kapërcehet pa problem.

Kjo vepër është destinuar në radhë të parë për albanologjinë dhe balkanologjinë, në mënyrë që të plotësohen njohuritë ende të pamjaftueshme të historisë së gjuhës shqipe dhe të saktësohet vendi i gjuhës shqipe mes gjuhëve fqinjë. Përveç kësaj ajo do të zgjerojë bazën materiale të indoeuropianistikës për foljen. Megjithëse shqipja është dëshmuar relativisht vonë, format e saj morfologjike shfaqin shumë dukuri të rëndësishme për rindërtimin e sistemit foljor të indoeuropianishtes.

Se sa i ndërlikuar është sistemi foljor i shqipes tregohet në kreun C, në të cilin kategoritë themelore (veta, numri, diateza, kohët, mënyrat) përshkruhen në mënyrë të detajuar. Befasues është inventari i madh në numër i formave sintetike, siç e tregon dallimi midis temës së të tashmes, së kryerës së thjeshtë dhe të dëshirores. Ndërsa tek format sintetike mund të skicohet lehtë inventari i formave, për format analitike inventari është më i vështirë të përcaktohet.

Krahas kohëve relativisht të qarta (si e kryera, më se e kryera), janë edhe disa kategori të shumta modale, që kanë një status shpesh problematik. Kjo shfaqet para së gjithash në strukturën e kompleksit foljor, në të cilin pjesëza të ndryshme marrin një funksion qendror dhe paraqesin dallime kuptimore.

Përpara se të rendisnin alfabetikisht konkordancat e fjalorit të foljeve, autorët duhej të zgjidhnin një varg detyrash tejet të vështira praktike. Për të sjellë shembujt nga tekstet në një formë shkrimore të njësuar, ishin të nevojshme analiza paraprake filologjike, d.m.th. duheshin shqyrtuar dhe rregulluar çështje të shumta dialektologjike, fonologjike dhe të teknikës së shkrimit.

Në punim hulumtohet edhe parahistoria e formave sintetike, prejardhja e tyre e mundshme nga indoeuropianishtja. Për këtë ishte e nevojshme një pamje e përgjithshme mbi zhvillimin e sistemit fonematik nga indoeuropianishtja në shqipen e vjetër, i cili trajtohet shumë shtjellueshëm, dhe më në fund jep edhe një skicë të thjeshtë të fonetikës historike të shqipes.

Zërat (artikujt) e fjalorit të konkordancave fillojnë, me pak përjashtime, me formën bazë (veta 3 e së tashmes së dëftores) të shqipes së sotme standarde, e cila formon kokën apo lemën e zërit. Më pas vijojnë, të renditura sipas secilit autor, format e dëshmuara, duke filluar nga ato të thjeshtat sintetike, përmes kohëve analitike e deri te format e pashtjelluara. Format e regjistruara jepen me

---

shkrim fonologjik të shënuar mes vizave të pjerrëta, mbas të cilit pason shkrimi origjinal me të dhënat burimore. Format foljore jo vetëm dokumentohen plotësisht, por përshkruhen saktësisht edhe nga ana fonologjike, gramatikore dhe etimologjike. Në njëfarë mase si shtojcë ka edhe disa etimologji të zgjedhura të foljeve. Bibliografia dhe indeksi i foljeve të regjistruara përmbyllin këtë vepër monumentale. Këtë punë gjigante të mundimshme duhet ta shënojmë pa asnjë rezervë si gur kilometrik në historinë e albanologjisë.

Burimi i informacionit:

digitales Rezensionsorgan für Bibliothek und Wissenschaft

<http://ifb.bsz-bw.de/bsz399908412rez-1.pdf>

Përktheu: **Anila Omari**

